

V E N D I M
Nr.425, datë 11.6.2001

PËR RRITJEN E PAGAVE TË GJYQTARËVE DHE TË PROKURORËVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2 dhe 6 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 "Për kompetencat për caktimin e pagave të punës", me propozimin e Kryeministrit, Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punës dhe Çështjeve Sociale dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Pagat e gjyqtarëve dhe të prokurorëve rriten në masën 8 për qind sipas pasqyrave që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi të përballohen nga buxheti i vitit 2001, miratuar për secilin institucion.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1.7.2001.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

PASQYRA NR. 1
PAGA MUJORE E PUNONJËSVE TË PROKURORIVE

1.1 Në Prokurorinë e Përgjithshme

1.	Prokuror i Përgjithshëm	99 317 lekë
2.	Prokuror i Gjykatës së Lartë	74 489 “
3.	Prokuror (drejtor drejtorie)	59 792 “
4.	Prokurorë të Prokurorisë së Përgjithshme	56 846 “

1.2 Në prokurorinë e apelit

1.	Prokuror apeli	59 792 lekë
2.	Zëvendësprokuror apeli	56 846 “
3.	Prokuror	50 965 “

1.3. Në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor të Tiranës

1.	Prokuror rrethi	56 846 lekë
2.	Zëvendësprokuror rrethi	50 965 “
3.	Prokuror	47 045 “
4.	Oficer i Policisë Gjyqësore	40 772 “

1.4. Në prokuroritë pranë gjykatave të rretheve gjyqësore

1.	Prokuror rrethi	50 965 lekë
2.	Zëvendësprokuror rrethi	47 045 “
3.	Prokuror	43 124 “
4.	Oficer i Policisë Gjyqësore	40 510 “

PASQYRA NR.2
PAGA MUJORE E GJYQTARËVE

2.1 Në gjykatën e apelit civil dhe në gjykatën ushtarake të apelit

1.	Kryetar	74 489 lekë
2.	Zëvendëskryetar	62 465 “
3.	Gjyqtar	58 806 “

2.2. Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor të Tiranës

1.	Kryetar	58 806 lekë
----	---------	-------------

2.	Zëvendëskryetar	51 951 “
3.	Gjyqtar	48 031 “

2.3 Në gjykatat e rretheve gjyqësore

1.	Kryetar	51 951 lekë
2.	Zëvendëskryetar	48 031 “
3.	Gjyqtar	45 085 “

PASQYRA NR.3

PAGAT E INSPEKTORATIT PRANË KËSHILLIT TË LARTË TË DREJTËSISË

3.1 Kryeinspektorë dhe inspektorë pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë

1.	Kryeinspektor	74 489 lekë
2.	Zëvendëskryeinspektor	62 465 “
3.	Inspektor	58 806 “